

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Driton Muharremi, kryetar, Xhevdet Abazi dhe Tonka Berishaj, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Syzana Goxhuli, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit V.H. nga fsh. ..., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprave penale të grabitjes nga neni 329 par. 1 të KPK-së, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, duke vendosur për ankesat e Prokurorisë Themelore - DKR në Prizren, dhe mbrojtëses së të akuzuarit av. M.C, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore - DKR në Prizren, P.nr.32/2017 të dt. 12.01.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK, me datën 04.01.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e pjesërishëm të ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit, por edhe sipas detyrës zyrtare, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore - DKR në Prizren, P.nr.32/2017 të dt. 12.01.2018, përkitazi me cilësimin juridik dhe vendimin për dënim, ashtu që Gjykata e Apelit, veprën penale grabitje nga neni 329 par. 1 të KPK-së, për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, e cilëson si vepër penale detyrimi nga neni 340 par. 2 të KPK-së, dhe vendimi për dënim, ashtu që tani për veprën penale të ricilësuar detyrimi nga neni 340 par. 2 të KPK-së, i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vjet e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 14.11.2015 e gjerë më dt. 26.09.2016 dhe dënim me gjobë në shumë prej 2.000 €, dënim ky i cili do të ekzekutohet menjëherë pas pranimit të aktgjykimit, ndërsa, nëse i akuzuari refuzon ta paguajë dënimin me gjobë i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim do t'i llogaritet në shumë prej 20 €.

Ankesa e prokurorisë por edhe ajo e mbrojtëses së të akuzuarit për bazat tjera ankimore, refuzohen si të pabazuara, ndërsa, aktgjykimi i ankimuar për pjesën tjetër vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore – DKR në Prizren, me aktgjykimin P.nr.32/2017 të dt. 12.01.2018, e ka shpallur fajtor të akuzuarin V.H., për veprat penale grabitje nga neni 329 par. 1 të KPK-së, dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së, dhe për këto vepra penale e ka gjykuar: për veprën penale grabitje nga neni 329 par. 1 të KPK-së, me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vite, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej dt. 14.11.2015 deri më dt. 26.09.2016, dhe dënim me gjobë në shumë prej 2.500 €, ndërsa, për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së, i ka shqiptuar dënimi me gjobë në shumë prej 800 (tetëqind) €, për çka, me aplikimin e dispozitave për shqiptimin e dënimit për veprat penale në bashkim, e ka gjykuar me dënim unik me gjobë në shumë 3.300 (tre mijë e treqind) €, dënim ky i cili do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, ndërsa, nëse i akuzuari refuzon ta paguajë dënimin me gjobë, i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që një ditë burg do t'i llogaritet në shumë prej 20 (njëzetë) €.

Të akuzuarin e ka detyruar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa, në emër të shumës së paushallit gjyqësor, shumën prej 600 (gjashtëqind) €, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të akuzuarit i ka shqiptuar dënimin plotësues dhe atë marrjen e pistoletës së tipit “Bruni Model 92”, me numër serik V048226 e prodhimit italian, si mjet me të cilin është kryer vepra penale.

Të dëmtuarin B.K., për realizimin e kërkesë pasurore – juridike e ka udhëzuar në procedurë kontestimore.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesa kanë paraqitur:

Prokuroria Themelore - DKR në Prizren, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënim, me propozim që të ndryshohet aktgjykimi i shkallës së parë, dhe i akuzuari V.H., të shpallet fajtor për vepër penale sipas kualifikimit juridik në aktakuzë dhe t'i shqiptohet dënim konform dispozitave ligjore të parapara për këtë vepër penale.

Mbrojtësja e të akuzuarit V.H., av. M.Ç, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe i akuzuari të lirohet nga akuza, ose të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Para se të flasim për pretendimet ankimore, kjo gjykatë konstaton se në këtë çështje penale-juridike, Gjykata e Apelit, në procedurë ankimore me aprovimin e ankesës së prokurorisë dhe mbrojtëses së të akuzuarit, e ka anuluar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, me aktvendimin PAKR.677/16 të datës 06.02.2017, dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim, për çka, pastaj, gjykata e shkallës së parë, pas procedimit të serishëm në rigjykim, me aktgjykimin P.nr.82/17 të dt. 12.01.2018, të akuzuarin V.H., e ka shpallur fajtor për vepër penale të grabitjes nga neni 329 par. 1 të KPK-së, dhe për vepër penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPK-së, aktgjykim ky i cili, në bazë të ankesës së mbrojtëses të akuzuarit është ndryshuar aktgjykimi i

ankimuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, PAKR.nr.129/18 të dt. 07.06.2018, dhe atë përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale dhe vendimit për dënim, ku tani i akuzuari është shpallur fajtor për veprën penale detyrimi nga neni 340 par. 2 të KPK-së, dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet, dhe dënimin me gjobë në shumë prej 2.000 €, ndërsa, dënimi i shqiptuar në shumë prej 500 €, për veprën penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, është marrë si i vërtetuar, ku pastaj, të akuzuarit bazuar në dispozitat e nenit 80 të KPK-së, i është shqiptuar dënimi unik me gjobë në shumë prej 2.500 €, mirëpo, në bazë të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë së mbrojtëses së të akuzuarit me aktgjykimin e Gjykatës Supreme Pml.229/18 të dt. 12.11.2018, është anuluar aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, PAKR.129/18 i dt. 07.06.2018, dhe atë vetëm përkitazi me vepër penale të detyrimit nga neni 340 par. 2 të KPK-së, dhe çështja përkitazi me këtë vepër penale është kthyer në rivendosje në këtë gjykatë, ndërsa, pjesa që ka të bëjë me veprën penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, ka mbetur e paprekur. Prandaj, tani në rivendosje, duke vepruar sipas aktgjykimit të Gjykatës Supreme, kjo gjykatë do të procedojë sipas ankesave për të gjitha bazat ankimore vetëm përkitazi me veprën penale grabitje nga neni 329 par. 1 të KPK-së, gjegjësisht, detyrimi nga neni 340 par. 2 të KPK-së.

Gjykata e Apelit, duke vepruar sipas aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pml.229/18 të dt. 12.11.2018, caktoi seancën e kolegjit konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK-së, për të cilën njoftoi Prokurorin e Apelit, të akuzuarin dhe mbrojtësen e tij si dhe të dëmtuarin. Në seancën e kolegjit ishin të pranishëm i akuzuari V.H. dhe mbrojtësja e tij av. M.Ç., i dëmtuari B.K. dhe përfaqësuesi i tij i autorizuar av. B.E., ndërsa, edhe pse i njoftuar në mënyrë të rregullt nuk prezantoi askush, nga Prokuroria e Apelit, për çka, gjykata e shkallës së parë, seancën e kolegjit e mbajti në mungesë të palëve të ftuara me rregull, konform dispozitave të nenit 391 par. 4 të KPK-së. Në seancën e kolegjit përfaqësuesi i palës së dëmtuar av. N.E. dhe i dëmtuari, pasi më parë sqaruan disa nga pretendimet ankimore ngelën në tërësi pranë propozimeve si në ankesë, ndërsa, mbrojtësja e të akuzuarit, po ashtu, pasi sqaroi disa nga pretendimet ankimore, ngeli në tërësi pranë propozimeve si në ankesa, të cilën e përkrahu edhe i akuzuari V.H..

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën PPA.nr.124/18 të datës 26.03.2018, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore – DKR në Prizren dhe ajo e përfaqësuesit të palës së dëmtuar të aprovohen, ashtu, që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe i akuzuari të shpallet fajtor sipas kualifikimit juridik në aktakuzë dhe të akuzuarit t'i shqiptojë dënime më të ashpër, ndërsa, ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje penale-juridike, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesa, gjeti se:

Ankesa e Prokurorisë Themelore –DKR në Prizren, nuk është e bazuar, ndërsa, ajo e mbrojtëses së të akuzuarit, pjesërisht është e bazuar.

Pretendimet ankimore përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjetjet e gjykatës.

Në ankesën e Prokurorisë Themelore – DKR në Prizren, përkitazi me këtë bazë ankimore pretendohet se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën par. 12 të KPPK-së, me arsyetim

se, i njëjti është i pakuptueshëm, i pa qartë dhe konfuz dhe atë sidomos në drejtim të ricilësimit të veprës penale të grabitjes nga par. 3 të nenit 329 në par. 1 të nenit 329 të KPK-së, ngase, edhe pse, gjykata e shkallës së parë, ka bërë ricilësimin e veprës penale, nuk ka dhënë vlerësimin e saktësisë së provave, përkitazi me këtë, sidomos nuk ka marrë parasysh ekspertizën mjeko ligjore të Dr. N.U., ku konstatohet se plaga ka mundur të shkaktohet edhe me armë, pastaj, duke marrë parasysh se arma në fjalë i është gjetur të akuzuarit në automjetin e tij, e pastaj, duke i ndërlidhur këtu faktet dhe rrethanat në fjalë edhe me deklaratën e të dëmtuarit, atëherë, pa mëdyshje që është dashur që i akuzuari të shpallet fajtor për vepër penale të grabitjes nga neni 329 par. 3 e lidhur me par. 1 të KPK-së, e jo sikur që ka vepruar në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, kur të akuzuarin e ka shpallur fajtor për vepër penale grabitje nga neni 329 par. 1 të KPK-së. Ndërsa, në ankesën e mbrojtëses së të akuzuarit përkitazi me këtë bazë ankimore pretendohet se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të parapara sipas dispozitës së nenit 384 par.1 nën par. 12 të KPPK-së, mirëpo, në arsyetimin e ankesës, përkitazi me këtë bazë ankimore, në fillim flitet kryesisht për një CD-e, e cila është dorëzuar nga pala e dëmtuar, e për të cilën gjykata e shkallës së parë, me aktvendim e ka shpallur provë të papranueshme, për çka, mbrojtësja e të akuzuarit pretendon se pikërisht momenti kur gjykata e shkallës së parë, e shpallë CD-e në fjalë, si provë të papranueshme, duhet të merret parasysh sjellja e të dëmtuarit në atë moment, i cili i pakënaqur me një gjë të tillë, fillon me ofendime, sharje dhe kërcënime dhe atë duke kërcënuar gjithashtu se çështjen në fjalë do të dërgojë në EULEX, por edhe sjelljet tjera të papranueshme, për çka, mbrojtësja por edhe vetë i akuzuari kanë kërkuar që seanca e mëtutjeshme e shqyrtimit gjyqësor të mbahet edhe me video incizim, pastaj, në arsyetimin e mëtutjeshëm theksohet, se gjatë mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor, i akuzuari gjithëherë ka qenë i kanosur nga i dëmtuari dhe se trupi gjykues edhe prokurori kanë punuar nën presionin e të dëmtuarit, gjë që edhe ka ndikuar që i akuzuari të shpallet fajtorë për vepër penale sipas aktakuzës së prokurorisë dhe krejt kjo me qëllim që i dëmtuari t'i ikë borxhit që e ka pasur ndaj të akuzuarit dhe përfundimisht përkitazi me këtë bazë ankimore, mbrojtësja e të akuzuarit pretendon se i dëmtuari qëllimisht ka bërë kallëzim penal të rrejshëm ndaj të akuzuarit, ngase, në rastin konkret nuk ka asnjë provë të vetme nga e cila do të vërtetohej se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën edhe është shpallur fajtor. Më tutje në ankesë, pretendohet se edhe për kundër faktit se të akuzuarit nuk i janë gjetur para, por as dokumente tjera për të cilat pretendohet se ia ka marrë të dëmtuarit ditën kritike, e as armë, sikur që pretendohet nga i dëmtuari se e ka përdorur ditën kritike, gjykata e shkallës së parë, prapë se prapë të akuzuarin e shpall fajtor, fakte këto dhe rrethana që nuk i vërtetojnë as dëshmitarët okular në vendin e ngjarjes – policët të cilët kanë qenë duke e kryer detyrën zyrtare, polic këta të cilët në deklaratat e tyre nuk i vërtetojnë faktet dhe rrethanat, se i akuzuari ka përdorur armë ndaj të dëmtuarit apo që edhe i ka shkaktuar lëndime, por bëhet fjalë për lëndimet që janë shkaktuar gjatë arrestimit të akuzuarit, e kurrësesi, këto lëndime t'i ketë shkaktuar i akuzuari, për çka, si pasojë e shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cekura si më lartë, i propozon gjykatës që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore të cekura si më lartë nuk qëndrojnë, ngase, aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara me ankesa e as shkelje tjera të cilat kjo gjykatë i shqyrton edhe sipas detyrës zyrtare, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit. Dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë, konkret, nuk përmban kundërtënie me vetë veten, e as me arsyetimin e tij, po ashtu, në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar janë dhënë arsye të mjaftueshme faktike dhe juridike, duke vënë në dukje se cilat fakte dhe për çfarë arsyerash i merr si të provuara ose të pa provuara, pra, ka bërë vlerësimin e të gjitha provave, duke përfshirë edhe provat kontradiktore konform dispozitave të nenit 370 par.7 të KPPK-së, pra, gjykata e shkallës së parë, ka bërë vlerësimin dhe analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor e duke i paraqitur lidhur me këto përfundimet e veta, të cilat edhe kjo

gjykatë i aprovon si të ligjshme dhe të drejta. Prandaj, arsyet të cilat i ka dhënë gjykata e shkallës së parë, kanë mbështetje në provat e procedura në seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe atë pjesërisht në vetë deklaratën e të akuzuarit, i cili nuk i konteston faktet dhe rrethanat se si është takuar me të dëmtuarin, se pastaj, të njëjtin e ka thirrë edhe përherë të dytë në telefon ku edhe kanë caktuar vendin për t'u takuar dhe atje pasi futet në automjetin e të dëmtuarit, nga pjesa e prapme e automjetit zbresin dy policë të cilët edhe e arrestojnë të akuzuarin, pastaj, po ashtu, pjesërisht në deklaratën e të dëmtuarit por edhe në deklaratat e dëshmitarëve F.K. dhe V.H. – polic të Policisë së Kosovës, deklarata këto – pra, të dy dëshmitarëve që janë edhe vendimtare në këtë çështje penale-juridike për vërtetimin e gjendjes faktike, ku edhe njëri edhe tjetri vërtetojnë se ditën kritike, pasi i dëmtuari B.K., shkon në polici për ta lajmëruar rastin, në ndërkohë, sa ishte në zyrën e policisë i akuzuari i lajmërohet në telefon të dëmtuarit, ku ky i fundit ia cakton takimin të akuzuarit, pra, duke thënë se do t'ia dorëzojë parat që i ka kërkuar i akuzuari dhe atë pasi që i ishte kërcënuar, se nëse nuk i paguan edhe shumën prej 40.000 €, do t'ia mbys familjen, fakte këto dhe rrethana që i vërtetojnë edhe dëshmitarët F.K. dhe V.H., por që kanë mbështetje edhe në provat tjera materiale në shkresa të lëndës, e pjesërisht edhe në vetë deklaratën e të akuzuarit. Po përkritazi me faktet vendimtare në këtë çështje penale-juridike gjykata e shkallës së parë, ka marrë parasysht deklaratën e të dëmtuarit B.K., nga e cila deklaratë është vërtetuar se para se i dëmtuari ta lajmërojë rastin në polici, me të akuzuarin, pasi më parë kishte kontaktuar përmes telefonit, kishin caktuar terminin e takimit me qëllim të arritjes së marrëveshjes për kryerjen e disa punëve nga i dëmtuari tek i akuzuari, ku pasi pajtohen për të arritur marrëveshje, futen në automjetin e të dëmtuarit dhe vazhdojnë rrugën për në shtëpinë e të akuzuarit dhe pasi vazhdojnë rrugën me automjet, i akuzuari i kërkon para të dëmtuarit duke iu kërcënuar me fjalët “ti ke para, qiti paratë”, për çka, i dëmtuari ia jep paratë që i kishte në xhep në shumë prej 2.500 €, ndërsa, i akuzuari para se të largohej i kërkon që t'ia sjellë edhe shumën tjetër prej 40.000 €, ose do t'ia mbys familjen, ku pastaj, pasi që i dëmtuari i premtonte se do t'ia sjellë edhe shumën prej 40.000 €, i akuzuari largohet nga automjeti, ndërsa, i dëmtuari me automjetin e tij vazhdon rrugën drejtë për në polici dhe lajmëron rastin dhe pasi që i akuzuari sërish lajmërohet në telefon, duke i kërkuar që t'ia dërgojë edhe shumën tjetër prej 40.000 €, atëherë, i dëmtuari së bashku me dy policët shkon në vendin e takimit, ku pasi i akuzuari hyn në automjetin e të dëmtuarit, të njëjtin e arrestojnë policët F.K. dhe V.H., fakte këto dhe rrethana që, përveç që vërtetohen nga i dëmtuari dhe dy dëshmitarët, e pjesërisht nga vetë i akuzuari, të njëjtat kanë mbështetje në provat materiale si foto dokumentacioni nga vendi i ngjarjes, pastaj, përmbajtja e SMS-ve në telefonin e të dëmtuarit, fakte këto dhe rrethana, pra, nga të cilat rezultojnë veprimet inkriminuese të akuzuarit e që përbëjnë elementet e veprës penale, por jo me cilësim juridik si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, për çka, më në detaje do të flitet gjatë elaborimit të bazës ankimore shkelje e ligjit penal. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, po ashtu, gjykata e shkallës së parë, ka dhënë vlerësimin e saj edhe përkritazi me faktet dhe rrethanat kontradiktore, pra, për faktet kundërthënëse, gjegjësisht, pjesën e deklaratës së të akuzuarit, ku i njëjti pretendon se paratë, të cilat ia ka kërkuar të dëmtuarit, i njëjti, pra, i dëmtuari ia ka pasur borxh, mirëpo, përkritazi me faktet dhe rrethanat në fjalë, gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar se pretendimet e të akuzuarit janë të pabaza dhe të pa argumentuara, ngase, me asnjë provë të vetme në shkresa të lëndës, nuk vërtetohet se i dëmtuari i ka pasur borxh të akuzuarit, pastaj, për pjesën e deklaratës së të dëmtuarit, ku deklaronte se i akuzuari ditën kritike ka përdorur edhe armë dhe të njëjtit i ka shkaktuar edhe lëndime trupore, pretendime këto që po ashtu, gjykata e shkallës së parë, nuk i ka aprovuar, ngase, të njëjtat nuk vërtetohen me prova tjera e sidomos me deklaratat e dëshmitarëve

okular në vendin e ngjarjes, por as në ekspertizën mjeko-ligjore, nga e cila konstatohet se lëndimet janë shkaktuar me mjete të forta – mbretëse, që do të thotë se nuk kanë mundur të shkaktohen vetëm me armë, por edhe me gjësende të tjera të topitura, për çka, edhe dy dëshmitarët okular në vendin e ngjarjes kanë deklaruar se i akuzuari ditën kritike nuk ka poseduar fare armë dhe të njëjtit nuk i janë shkaktuar lëndime trupore, ngase, i dëmtuari gjatë

lajmërimet të rastit në polici, pra, për rastin e parë, nuk ka qenë i lënduar, ndërsa, përkitazi me rastin e dytë kur është takuar me të akuzuarin, aty kanë qenë edhe dy dëshmitarët okular në vendin e ngjarjes, të cilët kanë deklaruar se nuk ka pësuar lëndime i dëmtuari, kurse, përkitazi me ekspertizën mjeko-ligjore, gjykata e shkallës së parë, po ashtu, ka pasur parasysh konkludimet, se lëndimet trupore kanë mundur të shkaktohen edhe me mjete tjera, për çka, përkitazi me këtë, pastaj, ka marrë parasysh edhe deklaratën e dëshmitarit V.H., i cili ka deklaruar se lëndimet trupore të dëmtuarit kanë mundur t'i shkaktohen edhe kur është rrëzuar në oborrin e stacionit të policisë, prandaj, edhe në këtë drejtim nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë, nuk ka dhënë arsye edhe për fakte kundërthënëse, për çka, e njëjta edhe në këtë drejtim ka dhënë arsyet e veta të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë. Ndërsa, pretendimet ankimore të prokurorisë përkitazi me këtë bazë ankimore e që kanë të bëjnë kryesisht me ricilësimin juridik të veprës penale, e që në fakt më tepër kanë të bëjnë me shkelje të ligjit penal, se sa me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, për çka, të njëjtat të njëjtat kjo gjykatë do t'i elaborojë tek baza ankimore e shkeljes së ligjit penal, kurse, përkitazi me shkelje esenciale, kjo gjykatë konstaton se nuk ka shkelje esenciale të pretenduara nga prokuroria por as shkelje tjera të cilat kjo gjykatë i shqyrton edhe sipas detyrës zyrtare, e që do të kushtëzonin anulimin e aktgjykimit të ankimuar.

Pretendimet ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penal dhe gjetjet e gjykatës.

Përkitazi me bazën ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, me ankesën e prokurorisë, pretendohet se gjykata e shkallës së parë, gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike, ngase, nga eksperti i mjekësisë ligjore vërtetohet se lëndimet e lehta trupore të dëmtuarit i janë shkaktuar me mjet mbretës, për çka, pastaj, i njëjti – pra, eksperti në fjalë, ka konkluduar, se ka mundësi që lëndimet të jenë shkaktuar edhe me armë, për çka, edhe përkundër ekspertizës në fjalë, gjykata e shkallës së parë, konstaton se të dëmtuarit nuk i janë shkaktuar lëndime trupore me armë, për çka edhe të akuzuarin e shpallë fajtor për vepër penale grabitje nga neni 329 par. 1 të KPK-së, e jo nga neni 329 par. 3 të KPK-së, e duke bërë pra, kështu edhe shkelje të ligjit penal, kuptohet në favor të akuzuarit. Ndërsa, mbrojtësja e të akuzuarit, av. M.Ç., përkitazi me këtë bazë ankimore, pretendon se gjykata e shkallës së parë, nuk e ka vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë, ngase, lëndimet trupore të dëmtuarit janë shkaktuar gjatë arrestimit të akuzuarit, por jo nga i akuzuari, pastaj, më tutje pretendohet se arma nuk është përdorur fare ditën kritike nga ana e të akuzuarit, ngase, e njëjta as që i është gjetur të akuzuarit, fakte këto dhe rrethana që i vërtetojnë edhe dy dëshmitarët në vendin e ngjarjes V.H. dhe F.K., ndërsa, përkitazi me parat që ia kanë kërkuar të dëmtuarit, pretendon se të njëjtat ia ka pasur borxh i dëmtuari të akuzuarit, për çka, konsideron se gjykata e shkallës së parë, ka bërë edhe shkelje të ligjit penal kur të akuzuarin e ka shpallur fajtor për veprën penale si në aktgjykimin e ankimuar, gjegjësisht të njëjtin është dashur ta lirojë nga akuza.

Gjykata e Apelit, konstaton se pretendimet e lartë cekura ankimore të prokurorisë, por edhe të mbrojtëses së të akuzuarit, përkitazi me gjendjen faktike nuk qëndrojnë, ngase, gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të plotë, ka vërtetuar gjendjen faktike, të përshkruar më detajisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, mirëpo, sa i përket aplikimit të ligjit penal, gjykata e shkallës së parë, gabimisht ka aplikuar ligjin penal, prandaj edhe qëndron pretendimi i mbrojtjes së të akuzuarit në këtë drejtim, por kuptohet pjesërisht, ngase, në rastin konkret sipas gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, rezulton se bëhet fjalë për vepër penale të detyrimit nga neni 340 par. 2 të KPK-së, e jo për vepër penale grabitje nga neni 329 par. 1 të KPK-së, sikur që ka vendosur gjykata e shkallës së parë, për çka, më në detaje do të flitet gjatë elaborimit të bazës ankimore shkelje e ligjit penal.

Përkitazi me gjendjen faktike në këtë çështje penale-juridike, sipas shkresave në lëndë, gjegjësisht, gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, rezultojnë si jo kontestuese faktet dhe rrethanat, se i akuzuari V.H., pasi më parë e thërret të dëmtuarin përmes telefonit, për kryerjen e disa punëve tek i akuzuari, të njëjtit – pra, i dëmtuari dhe i akuzuari takohen në vendin e caktuar sipas marrëveshjes, ku pasi i akuzuari futet në automjetin e të dëmtuarit, vazhdojnë rrugën për në shtëpinë e të akuzuarit, ku edhe duhej të kryheshin punët, kuptohet nëse do të arrinin marrëveshje. Po ashtu, jo kontestuese rezultojnë faktet dhe rrethanat, se pasi i dëmtuari shkon në Stacionin e Policisë dhe fillon ta paraqes rastin në polici, pra, për paratë që ia kishte marrë i akuzuari të dëmtuarit por edhe që i kishte kërkuar që t'ia sjellë edhe shumë tjetër prej 40.000 €, nën kërcënim se do t'ia mbys familjen, në atë moment në telefon i është lajmëruar sërish i dëmtuari, për çka, pastaj, e caktojnë vendin sipas marrëveshjes për t'u takuar sërish, ku para se i dëmtuari të shkojë në vendin ku e kishte lënë të takohet me të akuzuarin, në automjetin e të dëmtuarit – në pjesën e prapme janë futur edhe dy policët - dëshmitarët V.H. dhe F.K., ku me të arritur në vendin e ngjarjes, pasi që i akuzuari futet në automjetin e të dëmtuarit dhe i dëmtuari i njofton dy policët se ky është personi që po i kërkon para - të njëjtit, pra, policët e arrestojnë të akuzuarin dhe e dorëzojnë në stacionin e policisë, fakte këto dhe rrethana që gjykata e shkallës së parë, i ka vërtetuar edhe me provat tjera materiale, si fotot nga telefoni i të dëmtuarit, përmbajtja e SMS-ve në telefonin e të dëmtuarit dhe shkresave tjera në lëndë.

Ndërsa, përkitazi me faktet dhe rrethanat kontestuese në këtë çështje penale-juridike, pra, se paratë në fjalë i akuzuari a ia kërkoj të dëmtuarit në emër të borxhit, apo shumë prej 2.500 €, ia mori të dëmtuarit duke iu kërcënuar dhe atë duke i kërkuar që në ndërkohë t'ia sjellë edhe shumë prej 40.000 €, dhe atë nën kërcënim se do t'ia mbys familjen, pastaj se gjatë kanosjes se a e përdori i akuzuari edhe armën dhe ai shkaktoi edhe lëndime trupore të dëmtuarit, gjykata e shkallës së parë, përkitazi me faktet dhe rrethanat në fjalë, ka marrë për bazë së pari deklaratën e të dëmtuarit, të cilës pjesërisht ia ka falur besimin, e nga e cila ka vërtetuar se ditën kritike pasi i akuzuari e fton në telefon të dëmtuarin në vendin e caktuar me pretendim që të merren vesh për kryerjen e disa punëve nga ana e të dëmtuarit tek shtëpia e të akuzuarit, të njëjtit takohen dhe menjëherë i akuzuari futet në automjetin e të dëmtuarit duke i kërkuar që të shkojnë tek vendi ku duhet të kryhen punët, mirëpo, gjatë vazhdimet të rrugës me automjet, i akuzuari i drejtohet të dëmtuarit me fjalët “qiti paratë, se ti ke para”, ku pasi i dëmtuari në fillim i arsyetohet se nuk ka para, pastaj, pasi që kontrollohet nga i akuzuari dhe njëkohësisht i kërcënohet, i dëmtuari ia jep shumë prej 2.500 €, për çka, pastaj, i akuzuari e detyron të dëmtuarin ta ndalojë automjetin e që të zbres i akuzuari, mirëpo, i njëjti-para se të zbres, i drejtohet me fjalët “se nëse nuk i paguan edhe 40.000 €, kemi me ta mbytur familjen” për çka, i dëmtuari pasi i premtonte se do t'ia sjellë edhe 40.000 €, ndahet nga i akuzuari dhe me automjetin e tij shkon drejtë në stacionin e policisë, ku atje, fillon me paraqitjen e rastit, për çka, në ndërkohë i lajmërohet sërish në telefon i akuzuari, ku tani i dëmtuari e cakton vend takimin sipas marrëveshjes e duke i premtuar se do t'ia dërgojë edhe paratë në shumë prej 40.000 €, për çka, tani me të dëmtuarin në automjet shkojnë edhe dy polic - tani dëshmitarët V.H. dhe F.K. dhe me të arritur në vendin e ngjarjes, pasi më parë, i akuzuari futet në automjetin e të dëmtuarit për t'ia marrë paratë nga i dëmtuari, dëshmitarët – policët e Stacionit të Policisë në Prizren, dalin nga pjesa e prapme e automjetit ku ishin fshehur dhe e arrestojnë të akuzuarin. Faktet dhe rrethanat në fjalë i kanë

vërtetuar edhe dy dëshmitarët, V.H. dhe F.K., të cilët kanë vërtetuar se gjatë kohës derisa i akuzuari ishte brenda në stacionin e policisë duke lajmëruar rastin e të akuzuarit V.H., përkitazi me shumë e parave në lartësi prej 2.500 €, që ia kishte dhënë i akuzuari të dëmtuarit nën kërcënim, në atë moment në telefon i është lajmëruar një person duke i kërkuar të dëmtuarit që të takohen, ku pasi që i dëmtuari i njofton dëshmitarët në fjalë-policët e stacionit të policisë, se i akuzuari në telefon ia kërkon edhe paratë tjera, pra, shumë prej 40.000 €, merren vesh që ta caktojnë vend-takimin dhe pastaj me të dëmtuarin së bashku kanë shkuar edhe dy policët, ku me të arritur në vendin e ngjarjes, me t'u futurë në

automjet i akuzuari V.H., dëshmitarët – policët zyrtar V.H. dhe F.K., dalin nga pjesa e prapme e automjetit, ku ishin të fshehur dhe e arrestojnë tani të akuzuarin, mirëpo, sipas dëshmitarëve në fjalë të dëmtuarit gjatë këtij momenti nuk i janë shkaktuar kurrfarë lëndime trupore nga i akuzuari dhe po ashtu, nuk i është gjetur arma e as që është përdorur në momentin kritik arma në fjalë. Faktet dhe rrethanat në fjalë gjykata e shkallës së parë, i ka vërtetuar edhe nga foto dokumentacioni, përmbajtja e SMS-ve në telefonin e të dëmtuarit, por pjesërisht edhe nga vetë i akuzuari, i cili ka vërtetuar se ditën kritike e ka caktuar takimin me të dëmtuarin sipas marrëveshjes dhe atë si takimin e parë dhe takimin e dytë, mirëpo, kuptohet sipas mbrojtjes së të akuzuarit këtë e ka bërë për marrjen e parave që ia ka pasur borxh i akuzuari, pretendime këto, të cilat gjykata e shkallës së parë, i ka vlerësuar si të pabaza dhe të pa argumentuara, ngase, përveç deklaratës së të dëmtuarit, i cili në mënyrë kategorike e mohon një gjë të tillë, me asnjë provë në shkresat e lëndës, nuk vërtetohet se i dëmtuari i ka pasur borxh të akuzuarit, ndërsa, nga deklaratat e dëshmitarëve okular në vendin e ngjarjes, por edhe me provat materiale në shkresat e lëndës është vërtetuar se i akuzuari i është kërcënuar të dëmtuarit ditën kritike duke i thënë se do t'ia mbys familjen, nëse të akuzuarit nuk ia jep shumën prej 2.500 €, për çka, i dëmtuari ia jep paratë, por të njëjtit i kishte kërkuar po ashtu, që në ndërkohë t'ia sjellë edhe shumën prej 40.000 €, po ashtu, nën kërcënim se do t'ia mbys familjen, ku pastaj, i dëmtuari i premtonte të akuzuarit se do t'ia sjellë edhe shumën prej 40.000 €, për çka, i dëmtuari e ka caktuar edhe vendtakimin, mirëpo, në ndërkohë e ka njoftuar edhe policin, ku pastaj, së bashku me të dëmtuarin shkojnë edhe dy policët, të cilët edhe e arrestojnë të akuzuarin.

Prandaj, në bazë të një gjendje të tillë faktike të vërtetuar si më lartë, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, gabimisht ka aplikuar dispozitën e ligjit penal ku të akuzuarin e ka shpallur fajtor për vepër penale grabitje nga neni 329 par. 1 të KPK-së, ngase, sipas gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, e të përshkruar më detajisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, me veprimet inkriminuese të akuzuarit V.H., nuk plotësohen elementet e veprës penale të grabitjes nga neni 329 par. 1 të KPK-së, por në rastin konkret kemi të bëjmë me vepër penale të detyrimit nga neni 340 par. 2 të KPK-së, për arsye se i akuzuari V.H., me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore ndaj të dëmtuarit ka përdorur kanosjen serioze, duke i thënë se do t'ia mbys familjen, nëse i dëmtuari nuk vepron në dëm të pasurisë së tij, pra, duke ia dorëzuar paratë në shumë prej 2.500 €, aty për aty, ndërsa, në ndërkohë t'ia sjellë edhe shumën tjetër prej 40.000 €, prandaj, në bazë të veprimeve inkriminuese në fjalë të vërtetuara nga gjykata e shkallës së parë, pa mëdyshje që nuk mund të bëhet fjalë për vepër penale të grabitjes, por për vepër penale të detyrimit, për çka, kjo gjykatë e ndryshoi kualifikimin juridik të veprës penale duke i cilësuar pra, veprimet inkriminuese të akuzuarit në vepër penale të detyrimit nga neni 340 par. 2 të KPK-së, për çka, të njëjtin edhe e shpalli fajtor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pretendimet ankimore përkitazi me vendimin për dënim dhe gjetjet e gjykatës.

Duke e shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore - DKR në Prizren, se dënimi është i butë nuk qëndrojnë, ndërsa, ato të mbrojtëses së të akuzuarit, janë pjesërisht të bazuara. Në ankesën Prokurorisë Themelore - DKR në Prizren, theksohet se pasi që në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje të ligjit penal, në favor të akuzuarit me rastin e ricilësimit të veprës penale, atëherë, pa dyshim që kjo ka ndikuar që edhe vendimi për dënim të jetë i pa drejtë, ngase, i njëjti nuk i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë penale, por as rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, kurse, mbrojtësja e të akuzuarit, përkitazi me këtë bazë ankimore konsideron se pasi që në rastin konkret gjendja faktike nuk është vërtetuar në

mënyrë të plotë, e pastaj, edhe është shkelur ligjit penal në dëm të akuzuarit, atëherë, edhe vendimin për dënim e konsideron si të kundërligjshme, por pa cekur arsye tjera konkrete.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë, drejtë ka konstatuar të gjitha rrethanat që ndikojnë në caktimin dhe llojin e lartësisë së dënimit, siç parashihet në dispozitat e nenit 73 të KPK, ku si rrethana lehtësuese ka vlerësuar, sjelljen korrekte të akuzuarit në gjykatë, se i akuzuari nuk ka qenë i dënuar më parë, se i akuzuari është i moshës së re, ndërsa, rrethana rënduese nuk ka gjetur, mirëpo, të njëjtat nuk i ka vlerësuar realisht e sidomos kur merret parasysh ricilësimi i veprës penale nga vepra penale që ka qenë e paraparë në aktakuzë, për çka, edhe i ka shqiptuar dënimet me burgim dhe me gjobë, si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Prandaj, duke i pasur parasysh të gjitha këto rrethana, rrethanat e cekura në aktgjykimin e ankimuar, rrethanat e rastit konkret, Gjykata e Apelit, një konstatim të tillë të rrethanave e pranon edhe kjo gjykatë, mirëpo, duke pasur parasysh rrethanat lehtësuese të cilat i ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, për të akuzuarin si dhe njëkohësisht duke marrë parasysh ricilësimin e veprës penale tani nga Gjykata e Apelit, e me këtë dënim që parashihet për këtë vepër penale – pra dënim më i butë se sa që është paraparë sipas veprës penale të paraparë me aktakuzë, gjegjësisht aktgjykimin e ankimuar, kjo gjykatë vlerëson se edhe me dënimin e shqiptuar më të butë ndaj të akuzuarit, mund të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj, e aprovojë ankesën e mbrojtëses së të akuzuarit, në këtë drejtim dhe të akuzuarit i shqiptojë dënim me burgim dhe me gjobë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, me bindje se tani dënim i është adekuat me rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale si dhe përgjegjësinë penale të akuzuarit dhe se me një dënim të tillë mund të ndikohet edhe në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprës penale në të ardhmen si dhe rehabilitimin e tij, por edhe në parandalimin e të tjerëve nga kryerja e veprës penale, po ashtu, do ta forcojë moralin dhe detyrimin e shoqërisë për respektim.

Nga sa u tha më lartë, e konform dispozitës së nenit 401 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - PRISHTINË
PAKR.nr.587/2018, me dt. 04.01.2019.

Procesmbajtëse,
Syzana Goxhuli

Anëtarët e kolegjit,
1.Xhevdet Abazi

Kryetar i kolegjit,
Driton Muharremi

2. Tonka Berishaj